

VENDIM
Nr. 217, datë 20.3.2013

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ZYRËS SË
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
 2. Kategoria e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të jetë sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kategoria e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të jetë sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 4. Elementet përbërëse të pagës mujore të lidhjeve nr. 1 e nr. 2 janë si vijon:
 - a) Paga e grupit, e cila përcakton llojin e diplomës së nëpunësit, grupohet në tri nivele, sipas lidhjes nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Niveli i pagës së grupit është niveli minimal i domosdoshëm për çdo pozicion pune dhe kategorie page. Vlera e pagës së grupit për çdo nivel është e njëjtë me vlerën e kësaj page, të miratuar për nëpunësit civilë të administratës publike, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.
 - b) Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.
 - c) Shtesa e pagës për pozicion për çdo nivel është e njëjtë me vlerën e kësaj shtese të miratuar për nëpunësit civilë të administratës publike, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.
 - ç) Kategoritë e pagave për pozicionet e punës me emërtesë të njëjtë, përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe të organikës së secilit institucion.
 - d) Shtesa për kushte pune është sipas kolonës 4 të lidhjeve të sipërcituara.
 5. Niveli i pagave të nëpunësve, të cilët punojnë në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, është sipas lidhjes nr. 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 6. Për punonjësit mbështetës të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, struktura e pagës dhe përlllogaritja e saj është e njëjtë me atë të punonjësve mbështetës të administratës publike, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.
 7. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për ZRPP-në.
 8. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha